

RAPORT TEKNIK

Objekti : Rikonstruksion Rruga Strikçan

Bashkia Bulqize

**Autor i Projektit
“ERALD - G” shpk**

VITI - 2019

PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TE PERGJITHSHME


- 1.01 Hyrje**
- 1.02 Vend Ndodhja e objektit**
- 1.03 Gjendja Egzistuese**

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Projekti i Rruges
Veprat e Artit

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi me Çmime
Preventivi pa Çmime



4. SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. TE PERGJITHSHME

1.01 Hyrje

Me porosi te Bashkise Bulqize, eshte realizuar Projekt-Zbatimi per rrugen e fshatit Strikçan, qe lidh kete fshat me rrugen nationale Peshkopi - Tirane.


1.02 Vend Ndodhja e Objektit

Objekti “Rikonstrukcion Rruga Strikçan”, ka nje gjatesi rreth 900 ml.

1.03 Gjendja Aktuale e Objektit

Objekti aktualisht paraqitet ne nje gjendje jo te mire, ku gjate periudhes qe bien shira dhe reshje bore veshtiresohet se tepermi, pasi rruga eshte vetem ne trasene egzistuese ku asnjehere nuk jane bere nderhyrje per rikonstrukcion te saj. Pra ne kete rruge mungojne plotesisht shtresat rrugore dhe elementet e infrastruktures rrugore.

Sistemi i KUSH : mungon plotesisht. Ujrat rrjedhin ne trup te rruges, ne forme siperfaqesore sipas pjerresive natyrale te vete rruges, pasi kanalet anesore mungojne plotesisht. Tombionot Egzistuese thujse jane pa puseta e portale.





2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Projekti i Rrugeve

Rruga e Fshatit Strikçan, është projektuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Bashkia Bulqize. Ajo do të ketë një gjatësi të përgjithshme prej 5m në pjesën hyrëse të fshatit dhe 4m ; 3.8m ; 3.6m ; 3m në pjesët ku janë muret rrethuese të shtëpive (sipas projektit) , dhe do të përbehet nga :

- trupi i rruges me gjatësi 5m / 3.8m / 3.6m / 3m
- pjesa e asfaltuar me një pjerresi tërthore, 4m / 3.8m / 3.6m / 3m
- dhe në të dyja anët bankine me gjatësi 2x0.50 m (në segmentin me asfalt 4m)

Në pjesën në germim gjatë gjatësisë së rruges do të ketë kanal anesor, për ujrat e shirave.

Rruga e projektuar ruan përgjithësisht aksin e rruges ekzistuese duke bërë përmirësimet e mundshme gjeometrike të rruges.

- Shtresat ne trup te rruges

Paketa e plote e shtresave rrugore e percaktuar nga studimi i kryer do te permbaje keto shtresa :

- asfaltobeton 4 cm
- binder 6 cm
- stabilizant 10 cm
- çakell natyral 15 cm

Kjo pakete e shtresave rrugore do te ndertohet pasi te jene bere punimet e germim-mbushjeve te niveletes se rruges, dhe pasi trupi i rruges (bazamenti) te jete cilindruar.

Shtresa e pare do te sherbeje edhe si shtrese profiluese e rruges.

Projekti i Kanalizimeve dhe i Ujrave te Shirave

Rrjeti i kullimit te ujrave te shiut do te perbehet nga kanalet anesore te rruges, ne pjesen ne germim, pusetat dhe portalet e tombinove si dhe tubacionet dhe betoni dhe celiku qe do te ndertohen ne trupin e rruges.

Tubacionet do te plotesojne te gjitha standartet ne fuqi dhe ne projektin e zbatimit jepen te gjitha normat dhe specifikimet e nevojshme. Kjo vlen edhe per te gjitha materialet e tjera qe do te perdoren.

Pusetat e tombinove do te kene dimensione te ndryshme, kjo ne varesi te terenit dhe te dimensionit te tubit te tombinos.

Do te ndertohen puseta e portale dhe ne disa tombino egzituese.

Projekti i Sinjalistikes Rrugore

Ne projektin e sinjalistikes rrugore eshte parashikuar Sinjalistika Horizontale dhe ajo Vertikale.

- **Sinjalistika Horizontale** perbehet nga :

1. Vijezimet
 - a) Vijezimi do te behet ne te dy anet e pjeses se asfaltuar, me gjeresi 15 cm sejcila.
 - b) Ne zonat prane degezimeve dhe kryqezimeve rrugore, do te vijezohe me vije te nderprere.

- **Sinjalistika Vertikale** perbehet nga :

1. Tabelat treguese

Shenim : Projekti i Sinjalistikes, gjate zbatimit te objektit, mund te ndryshohet nga Bashkia Bulqize.

**“ERALD – G” Sh.p.k.
ADMINISTRATOR**

Ing. Gezim ISLAMI

